

VENDIM
Nr.78, datë 17.2.1997

**PËR NDIHMËN E SHITETIT PËR QYTETARËT QË KANË SHITUR SHTËPITË DHE
KANË DEPOZITUAR PARATË NË FONDACIONET OSE KOMPANITË HUAMARRËSE
QË KANË FALIMENTUAR**

Me propozimin e Kryetarit të Këshillit të Ministrave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Gjithë qytetarët që kanë shitur apartamentet e tyre dhe kanë depozituar paratë në fondacionet a kompanitë huamarrëse që kanë falimentuar, quhen të pastrehë dhe do të përfitojnë sipas ligjit nr.8030, datë 15.11.1995 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”.
 2. Bashkitë të ngrenë menjëherë komisionet përkatëse, të hartojnë listat e qytetarëve, të verifikojnë dokumentacionin përkatës, t’i miratojnë ato në këshillin bashkiak dhe t’i dërgojnë në Bankën e Kursimeve, e cila t’i trajtojë ato me përparësi të veçantë.
 3. Në qoftë se qytetarët kanë përfituar pjesërisht nga fondacionet ose kompanitë huamarrëse të falimentuara, masa e përfitimit falas nga shteti do të llogaritet sipas ligjit nr.8030, datë 15.11.1995, duke u zbritur pjesën që ata kanë përfituar pjesërisht.
 4. Nëse qytetarët e mësipërm do të përfitojnë nga likuidimi i pasurive të fondacioneve e kompanive huamarrëse të falimentuara, nga shuma e përfitimit do t’u zbritet pjesa që ata kanë përfituar falas nga shteti tërësisht a pjesërisht sipas rastit dhe kurdo që ajo do të ndodhë.
 5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit të nxjerrin udhëzimet përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi